



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

14-020/04-OMM 527/18, më 11. 05. 2018

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), dhe të dispozitave të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR ZHVILLIMIN E DISKUTIMIT PUBLIK TË RREGULLORËS PËR CAKTIMIN E VLERËS REFERENTE INVESTUESE TË PROJEKTIT TË NDËRTESAVE PËR CAKTIMIN E TARIFËS PËR LEJE MJEDISORE NË KOMUNËN E PRISHTINËS

- I. Miratohet vendimi për formimin e komisionit për zhvillimin e diskutimit publik të rregullores për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore në Komunën e Prishtinës.
- II. Komisioni i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:
 1. Burbuqe Hydaverdi, Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, kryesuese;
 2. Jehona Mavraj, Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm anëtare;
 3. Anita Osmani, Drejtorja për Urbanizëm, anëtare;
 4. Ferit Fazliu, Drejtorja për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, anëtarë;
 5. Leonora Sadiku, zyrtare ligjore, anëtare;
 6. Ibrahim Morina, Drejtorja e Financave, anëtarë.
 7. Osman Bllaca, auditor i brendshëm, anëtarë.
- III. Detyrë e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi, është që të kujdeset për zhvillimin e diskutimit publik të rregullores për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore në Komunën e Prishtinës. Të shqyrtojë dhe evidentojë të gjitha ankesat, vërejtjet dhe sugjerimet e publikut të bëra gjatë diskutimit publik.
- IV. Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.

V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

